



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 · E-mail: rektorati@uni-pr.edu · eëë.uni-pr.edu

Fakulteti: Bujqësisë dhe Veterinarisë

Departamenti: Agroekonomisë

Programi: Ekonomia e Bujqësisë dhe Ushqimit

NJOFTIM

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se :

Ekzemplari (drafti) i temës së masterit i punuar nga kandidati/ja **Bsc. Melihate Isufi**, me titull: **“Preferencat e konsumatorëve ndaj kulturës së mjedrës dhe boronicës në komunën e Podujevës”** ndodhet në diskutim publik 7 ditë nga data **19/03/2025** deri me datë **25/03/2025**.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Prof. Asoc. Dr. Vahid Adiu - kryetar/anëtar
2. Prof. Asoc. Dr. Njazi Bytyqi - mentor/anëtar
3. Prof. Ass. Dr. Prespa Ymeri - anëtar.

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonte te udhëheqësi shkencor i temës Prof. Asoc. Dr. Njazi Bytyqi, përmes e-mail adresës njazi.bytyqi@uni-pr.edu

Për të pasur një informacion paraprak më poshtë e gjeni një përmbledhje të shkurtë përmes abstraktit të temës.

Çdo sugjerim i juaji mund të jetë një pasurim i punës tonë !

ABSTRAKT

Studimi analizon preferencat e konsumatorëve ndaj kulturës së mjedrës (*Rubus idaeus*) dhe boronicës (*Vaccinium spp.*) në komunën e Podujevës, duke u fokusuar në faktorët që ndikojnë në zgjedhjet e tyre dhe potencialin për zhvillimin e këtyre kulturave në rajon. Përmes anketimit të konsumatorëve lokalë, janë identifikuar preferencat për këto dy fruta në lidhje me shijen, përfitimet shëndetësore, çmimin dhe disponueshmërinë. Rezultatet tregojnë një interes të lartë për boronicën, kryesisht për shkak të përmbajtjes së saj të lartë të antioksidantëve dhe përfitimeve shëndetësore. Ndërkohë, mjedra preferohet për shijen e saj të ëmbël dhe përdorimin në produkte të ndryshme ushqimore. Studimi identifikon faktorët kryesorë që ndikojnë në preferencat e konsumatorëve, përfshirë çmimin, cilësinë, disponueshmërinë dhe përfitimet shëndetësore. Faktorët demografikë si moshën, gjinia dhe niveli i të ardhurave ndikojnë gjithashtu në zgjedhjet e konsumatorëve. Konsumatorët më të rinj dhe ata me nivele më të larta të ardhurave tregojnë një preferencë më të lartë për boronicën, ndërsa konsumatorët e moshuar preferojnë mjedrën për shkak të shijes tradicionale dhe përdorimit në receta të njohura. Studimi sugjeron se ka një potencial të madh për rritjen e prodhimit dhe konsumit të këtyre frutave në Podujevë, duke u bazuar në preferencat e treguara dhe trendët e konsumit. Për të maksimizuar këtë potencial, rekomandohet promovimi i përfitimeve shëndetësore të këtyre frutave dhe zhvillimi i strategjive të marketingut të përshtatura për nevojat e konsumatorëve lokalë.

Fjalët kyçe: Preferencat e konsumatorëve, mjedra, boronica, komuna e Podujevës.